



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:270702

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05502821

A.C.nr.1173/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryetar, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtar, në çështjen juridike të paditëses M.G. me vendbanim në Rr. "...", nr....., Komuna Gjilan të cilën me autorizim e përfaqëson F.Sh., avokat me seli në Komuna Gjilan, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në rrugën "Lidhja e Pejës", pa nr. Komuna Prishtinë të cilën e përfaqëson Dijellza Hajdari, juriste nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.69/18 datë 30.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 25.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZHET e pathemeltë, ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Rrugën "Lidhja e Pejës", pa nr. Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.69/18 datë 30.10.2020, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.69/18 datë 30.10.2020, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadija e paditëses M.G. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura, Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 5,362.00€ edhe atë:

a. Dëmin jo material:

- në emër të dhimbjeve fizike të përjetuara shumën prej 1.975,00 €*
- në emër të frikës së përjetuar shumën prej 1,032 €*
- në emër të shëmtimit të përjetuar shumën prej 700,00 €*
- në emër të zvogëlimit të aktivitetit jetësor shumën prej 900€*

b.Dëmin material:

- në emër të ndihmës personit të tretë shumën prej 245 €*
- në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 210 €*
- në emër të shpenzimeve të shërimit-mjekimit rehabilitim fizioeterapeutik dhe psikik shumën prej 300€ €*

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data e pranimit të këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

II. DETYROHET e paditura shumën e përgjithshme më lartësi prej 3.058,00 € dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumën prej 1.269€ t’ia paguaj paditësit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit...”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë e paditura, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta aprovoj ankesën e të paditurës, dhe ta prishë aktgjykimin e atakuar ashtu që lëndën t’ia kthejë Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi me propozim Gjykatës së Apelit që të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e të paditurës, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja M.G. nga Komuna Gjilan, me datë 11.01.2018, ka paraqitur padi, ndaj të paditurës, me kërkesë për kompensimin e dëmit.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.69/18 datë 30.10.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *“... Mbi bazën e kësaj gjendjeje faktike, gjykata vlerësoi se e paditura mban përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditësit me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditësit t’ia kompensojë dëmin, në bazë të nenit 136 par.1 të LMD-së, në bazë të përgjegjësisë që parashihet: “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.” dhe nenit 156 par.1 po të njejtit ligj në të cilin citohet: “Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit.”, andaj duke u bazuar në dispozitat e cekura më lart si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jomaterial, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore që i janë shkaktuar paditësit dhe moshën e tij, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lart, gjykata e miratoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblim real dhe objektiv dhe me bindjen se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, dhe nuk është kontestuar baza juridike gjatë shqyrtimit të kësaj procedure kontestimore në Gjykatën e shkallës së parë nga e paditura, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike, për të cilat arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si reale shumën sa i përket vendosjes së kompensimit të paditëses për dëmin material, dhe jo material ku edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar, pasi në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor Dr. M.H., rtoped, të cilët ekspertë kanë konstatuar se në bazë të ekzaminimit të jashtëm të paditëses dhe në bazë të dokumentacionit që është prezantuar dhe atë ajo e emergjencës së Spitalit në Gjilan si dhe raporteve mjekësore kanë konstatuar se paditësja M.G., si pësojë e aksidentit të komunikacionit me datë 31.12.2015, ka pësuar ndrydhje koke, natyra e lëndimeve të rënda, po ashtu eksperti ka konstatuar se paditësja nga ky aksident ka përjetuar dhimbje të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 30 min., dhimbje të intensitetit të mesëm 25 ditë, dhimbje të intensitetit të ulët në

kohëzgjatje ka sot edhe kësaj dite. Ndihej e personit të huaj ishte e nevojshme në kohëzgjatje prej 35 ditëve, ushqimi i përforcuar ishte i nevojshëm në kohëzgjatje prej 30ditëve, rehabilitimi fizio terapeutik dhe klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 15 ditësh. Ndërsa Eksperti Dr. A.C., Psikiatër, në lidhje me frikën e përjetuar si pasojë e aksidentit në bazë të dokumentacionit mjekësorë si dhe ekzaminimit direkt të paditëses M.G., ka konstatuar se paditësja ka përjetuar frikë primare të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 2 min., frikë sekondare me intensitet të mesëm dhe të ulët ka pasur një minutë, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Në nenin 169 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, në mënyrë decidive thuhet se *"Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi"*.

Ndërsa në nenin 179 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndër të tjera thuhet se *"Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë..."*.

Pretendimi ankimor i të paditurës se ka kontradiktë sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore ky pretendim është i pa bazuar, pasi që pika II e aktgjykimit të atakuar mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 par. 1, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Nuk qëndrojnë pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë ka pranuar të gjitha propozimet e palëve ndërgjyqësore për administrimin e provave të propozuara nga to me të cilat gjykata i ka provuar faktet vendimtare të çështjes sipas të cilave ka vendosur për themelësinë e kërkesëpadisë.

Pretendimi ankimor i të paditurës se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka arsyetuar bazën e përgjegjësisë së të paditurës, ky pretendim është i pa bazuar pasi që nga e paditura nuk është kontestuar baza juridike gjatë shqyrtimit të kësaj procedure kontestimore në Gjykatën e shkallës së parë, po ashtu e paditura në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në Gjykatën e shkallës së parë me datë 25.11.2019 ndër të tjera ka deklaruar se *"...me qellim të ekonomizimit të procedurës paditesit ne emër të të gjitha formave të demit material dhe jo material i ofrojmë shumën prej 1200€..."*.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuara pretendimet në ankesë të palës së paditur se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sa i përket lartësisë së kompensimit, pasi vlerëson se shumën e gjykuara nga Gjykata në shkallë të parë, janë reale duke u bazuar edhe në lëndimet e pësuar nga paditësja.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.1173/2021 datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit – gjyqtari
Bujar Muzaqi